



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/58  
Datë: 27.01.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 53, 54, 55 dhe 56 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 02/58  
Datë: 27.01.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 55 të Ligjit nr.2004/42 për Veprimtarinë Kërkimore - Shkencore, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Për propozimin e pesëmbëdhjete anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës në këtë përbërje:
  - 1.1. Fetah Podvorica;
  - 1.2. Emine Bakalli;
  - 1.3. Zymer Neziri;
  - 1.4. Naser Sahiti;
  - 1.5. Shyqeri Nimani;
  - 1.6. Isa Haxhiu;
  - 1.7. Nexhmi Rexha;
  - 1.8. Alush Musa;
  - 1.9. Eda Vula;
  - 1.10. Radivoje Mancic;
  - 1.11. Bajram Berisha;
  - 1.12. Zejnullah Gruda;
  - 1.13. Jusuf Krasniqi;
  - 1.14. Dukagjin Popovci;
  - 1.15. Sefrik Dogmak.
  
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat e të propozuarve së bashku me biografitë e tyre t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/58  
Datë: 27.01.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 15 paragrafi 7, të Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2012, mori:

**V E N D I M**

Për themelimin e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të UÇK-së, veteranit pjesëtarit të UÇK-së, apo të internuarit të UÇK-së (Komisioni)

1. Komisioni përbëhet nga këta përfaqësues:

- 1.1. Azem Syla-Ish Shtabi të Përgjithshëm të UÇK-së- Kryesues;
- 1.2. Faik Fazliu ZVL- UÇK Zyra e Kryeministrit;
- 1.3. Fadil Rracaj- Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale;
- 1.4. Jahir Demaku- Ministria për FSK;
- 1.5. Sami Lushtaku - Ish Z.O.D e UÇK-së;
- 1.6. Sadik Halitjaha - Ish Z.O.P e UÇK-së;
- 1.7. Shkumbin Demaliaj - Z.O.D e UÇK-së;
- 1.8. Rrahman Rama - Ish Z.O.SH e UÇK-së;
- 1.9. Qelë Gashi - Ish Z.O.LL e UÇK-së;
- 1.10. Shukri Buja - Ish Z.O.N e UÇK-së;
- 1.11. Ahmet Isufi - Ish Z.O.K e UÇK-së;
- 1.12. Avdi Raci - Ish SHP TMK-së;
- 1.13. Muharrem Xhemajli - OVL-UÇK-së;
- 1.14. Xhavit Jashari- Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së,
- 1.15. Fadil Shurdhaj- Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së,
- 1.16. Rrustem Berisha- Ish Ministria e Mbrojtjes,

2. Organizimi i punës, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë, pagesa për angazhimet e anëtarëve si dhe çështjet tjera të rëndësishme të Komisionit Qeveritar do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës sipas nenit 15, paragrafit 8 të Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.
3. Për realizimin e objektivave në mënyrë të suksesshme, Komisionit Qeveritar, duhet t'i ofrojnë asistencë teknike; Zyra për Çështjet e kategorive e dala nga Lufta, Zyra Ligjore e ZKM-së dhe sipas kërkesës së Komisionit të gjitha njësitë përkatëse qeveritare.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr.4/121 i Qeverisë së Kosovës i nxjerr me datën 22.04.2010.
5. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/58  
Datë: 27.01.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohen ndryshimet për përmbushjen e obligimeve të pakryera financiare nga viti paraprak për projekte kapitale shumëvjeçare në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-079 - Tabela 3.2 - Projektet kapitale për vitin 2012.
2. Obligohen Ministritë e ndikuara dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë për njoftim Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë